

## MOÇMËRIA E VENDBANIMIT TË VUSHTRISË

Prezantuar përmes monumentit mbivarror/stelës dhe mozaqeve)

Jeton SALLAHU<sup>1</sup>

<sup>1</sup>\*Corresponding author e-mail: jetoni\_juve@hotmail.com

---

### Abstrakt

Punimin studimor të cilin jemi munduar ta trajtojmë titullohet “Moçmëria e vendbanimit të Vushtrisë prezentuar përmes monumentit mbivarror/stelës dhe mozaqeve”, kësajsojshëm të emërtuar duke dashur të provojmë ekzistimin e vendbanimit në truallin e sotëm të Vushtrisë me rrethinë në antikitet, fillimshëm përmes një monumenti mbivarror/stelës dhe më pastaj kemi ofruar disa të dhëna rreth mundësisë së ekzistimit të mozaqeve në truallin e sipërpërmendur. Njashtu përmes këtij studimi jemi munduar të nxjerrim në pah edhe talentin e banorëve të kësaj ane, ilirodardanët, rreth artit, duke mospërfshuar këtu edhe ndikimet nga kulturat e tjera.

**Fjalët çelës:** *Moçmëria, trualli i Vushtrisë me rrethinë, ilirodardanët, monumenti mbivarror/stela, mozaiket.*

### Abstract

The study paper that we have tried to address is entitled “The existence of the settlement of Vushtri presented through the tombstone/stele and mosaics”, so named because we wanted to prove the existence of the settlement in the present-day land of Vushtri with its surroundings in antiquity, initially through a monument gravestone/stele and then we have provided some data about the possibility of the existence of mosaics in the aforementioned plot. Likewise, through this study, we have tried to highlight the talent of the inhabitants of this area, the Ilyrodardans, regarding art, not excluding the influences from other cultures.

**Key words:** *Seniority, Vushtri land and its surroundings, Ilyrodardans, tomb monument/stele, mosaics.*

---

### Dy fjalë për kulturën e popullatës autoktone në antikitet

Kultura e popujve n’varet shumëherë nga shkalla e zhvillimit ekonomik e social të tyre popujve. Krahas këtyre faktorëve që mund të ndikojnë në zhvillimin kulturor të popujve, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë në këtë zhvillim, si, tradita e kultivuar dhe e ruajtur ndër gjenerata, kontakti me kulturat e tjera, por pa kaluar në shkallën e ndikimit të fort që mund të qoj në tjetërsim, pastaj pozita gjeografike, e faktorë të tjerë.

Territori i sotëm i Republikës së Kosovës, dhe jo vetëm, nëse flasim për antikitetin-Dardaninë, banohej shumicërisht me etnitetin ilir, respektivisht ilirodardan, pa përjashtuar këtu edhe popullatat e tjera më të imëta, thrakasit në radhë të parë e që i kemi përmendur gjetiu. Këtej, nëse flasim për profesionistët që janë marrë me çështje të tilla, sikurse mund ta përmendim studiuesen Papazoglou, ajo përmes studimeve të saja na bënë të ditur lidhjet midis etnitetit të sapopërmendur me historinë e popullit shqiptar, në kuptim të ngushtë.<sup>411</sup>

---

<sup>411</sup>Exhlale Dobruna, *Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë* në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike” (IV-V 1974-1975, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1977), p.p.43-73; Exhlale Dobruna, *Plastika dekorative dhe figurative e stelave mbivarrorë të periudhës romake në Kosovë* në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike” (14-1984, Instituti Albanologjik i Prishtinës,

Atëherë nga kjo kuptojmë se edhe Vushtrria e sotme, respektivisht një pjesë kulturore e saj që edhe do të flasim, ishte pjesë përbërëse e këtyre rrjedhave që përmendëm sipri. E pra edhe treva në fjalë, anipse kishte ndikimet nga jashtë, ajo megjithatë ruajti edhe vetitë e saja burimore, individuale.

Siç dihet monumentet për të cilat edhe do të flasim, futen si pjesë e kulturës materiale, ndonëse fakti se ato përmbajtësisht kanë pasur edhe përkushtime, mund të futen edhe te kultura shpirtërore. Këtu njohja e këtyre copëzave të kulturës na mundëson provimin e pranisë së vazhdueshme të popullatës në trajtim në këto anë. Megjithatë koha e “ndalesës” është kryesisht ajo e okupimit romak, okupim ky që solli dëme për popullatën autoktone, ndonëse duke pasur parasysh zhvillimin e gjithmbarshëm të romakëve, ata njëkohësisht ndoshta paradoksalisht, kishin pas sjellur edhe një lloj qytetërimi, qoftë në trevat ilirofolëse, apo edhe në trevat e tjera ku ata ishin pas shtrirë.<sup>412</sup>

### **Monumenti mbivarror/stela e gjetur në Vushtrri**

Kur flasim për antikitetin, njohuritë për shoqëritë e asaj kohe, vendbanimet, e informacionet e tjera për çështje të tjera, janë me rëndësi shënimet e autorëve antikë, megjithatë krahas atyre burimeve, duhet t’kërkohen edhe burimet e tjera të cilat do ti paraqitnin çështjet më të kjarta. Kësisoj nëse referohemi tek autori antik Straboni, ai na thotë se vendbanimet/qytetet ekzistonin në territorin dardan,<sup>413</sup> megjithatë nuk e dijmë me siguri se për çfarë niveli të qyteteve e kishte fjalën ai.

Nga territori i sotëm i trevës së Vushtrrisë, para do kohe është gjetur një monument mbivarror i tipit stele.

---

Prishtinë, 1985), p.p.7-18; Exhlale Dobruna, *Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë* në revisten “Iliria” (nr.2, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë, 1982), p.207.

<sup>412</sup>Exhlale Dobruna, *Veprat e artit ilir në plastikën potretore të kohës romake në trevën e Dardanisë* në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike” (24-1994, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1996), p.p.21-23.

<sup>413</sup>Ilirët si mjeshtër janë dalluar me Teknikën e Gravurimit, teknikë e kahershme, punuar në drunjë, por edhe në gurë. Për më shumë, shih, Exhlale Dobruna-Salihu, *Mbi besimin...opcit.*



Fig.1.Stele me mbarim trekëndësh nga Vushtrria Fig.2.Stele nga Vushtrria e vizatuar

Në vijim po paraqesim disa nga veçoritë e kësaj steljeje:

Materiali: *Mermer i bardhë*

Lartësia: *1,00 m*

Gjerësia: *0,48 m*

Trashësia: *0,21 m*

Gjetur: *Në Vushtrri*

Ruhet: *Në Muzeun Arkeologjik të Shkupit*

Stelia që e kemi në trajtim nuk është e plotë. Asaj i mungon pjesa e poshtme, ngase mjedis mbishkrimit është thyer me një vij të pjerrët nga e majta në të djathtë, prandaj nuk i dihet fundi i stelës. Megjithatë nga kjo mund të nxjerrën disa të dhëna interesante. Së këndeje aty janë prezentuar tre persona deri në brez e të punuar në relief të bukur. Nga ana e majtë, figura paraqet një grua të veshur, e që në njëren dorë mbanë diç, sipas studiueses Exhlale Dobrunes mund të ishte ajo një pergament e paluar rrotull/volumen, që simbolizon drejtën qytetare romake (?). Tutje, koka e saj është e zbuluar, gjersa flokët i ka të kapura mbas. Ndërsa në anën e djathtë gjenden dy meshkuj.

Zakonisht, këto janë të rrethuara nga hardhia me gjethe urthi, e nëse referohemi tek studiuesi Cumont, ai thotë se jeta vazhduese në bimët me gjethe të gjelbërta, që qëndrojnë ndër stinët e vitit, është arsye e paraqitjes së urthit në monumentet mbivarrore, ngase simbolizojnë pavdekshmërinë. Këtej, edhe edhe hardhia e rushit simbolizon shpresën dhe besimin në jetën e pëртеjvarrit.<sup>414</sup>

<sup>414</sup>Jeton Sallahu, Burim Rexhepi, Bedri Xhema, Zahir Kastrati, *Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa e parë* (Faik Konica, Prishtinë, 2017), p.24.

Disa karakteristika të tjera të monumentit që e kemi në trajtim janë: Relievi është më plastik, tutje të punuarit e paraqitjes figurative është më i mirë se shumë të tjerë, të trija figurat e paraqitura proporcionalisht janë mirë, veçanarisht veçoritë e fytyrës së femrës dallohen, gjersa te fytyrat e meshkujve ka dëmtim.

Kjo do të thotë, se nga ana artistike është me kogja vlerë.<sup>415</sup> Prandaj **arti** dhe **zanati**, paraqitja figurative e të ndjerëve përmes potreteve në formen e busteve i treguar nga ndikimi romak, anipse ndikime kishte edhe nga të tjera kultura, si ajo greke e ndonjë tjetër, përmes gjuhës latine, por duke mos anashkaluar këtu edhe zotësinë e popullatës vendëse ilirodardane e cila përdorte ndoshta edhe njëfarë latinçe vullgare, gjersa në rrethin e saj familjar vazhdonte ta kultivonte gjuhën e saj-atë ilire. Së këndejmi, kjo popullatë vendëse ishte pas prezentuar qoftë me mjeshtrit autodidakt,<sup>416</sup> apo me mjeshtër nëse mund të themi “me kryrje shkollë”, gjë që tregon aftësinë dhe vitalitetin e saj, e njëkohësisht është provë se shumicërisht ajo nuk u tjetërsua. Kjo që u tha sipri, do të thotë edhe një tjetër gjë, e kemi fjalën se në trevën dardane ekzistonin dhe **punëtoritë** që kryheshin veprat në fjalë, ndaj në disa stela ka qenë e përdorur *Teknika e Gravurimit*, dëmthënë teknikë e zhvilluar nga ilirët në gurë, por dhe në drunjë.<sup>417</sup>

E nga që u tha deri tani, mund të themi se popullata e trevës që e trajtuam, i kushtonte rendësi jetës së amshueshme/jetës së përtejvarrit, e dëshmi është edhe monumenti i trajtuar në këtë punim, prandaj edhe sot neve duhet ti kushtojmë vëmendje varreve tona, qoftë duke i zgjedhur e ruajtur në vendet adekuate, qoftë duke i shënuar të dhënat kryesore të “iks” individëve, qoftë duke i shoqëruar me ndonjë simbol kombëtar, qoftë duke i prezentuar pamjen, natyrisht nuk përjashtohet edhe vendosja e ndonjë simboli fetar.

### **Në Vushtrri me rrethinë mund të ekzistojnë mozaiket**

Në trevën e sotme të Vushtrrisë, respektivisht ndër gjeneratat e popullatës të kësaj treve, ka qarkulluar mendimi se ka ekzistuar **mozaiku**. Por, deri tani ai nuk është gjetur. Megjithatë fakti që ai deri tani nuk është gjetur, kjo nuk do të thotë që ai nuk ekziston.

Ne qysh në vitin 2017 e kemi përmendur shkrueshëm se ai-**mozaiku** mund të ekzistoj, natyrisht duke pasur për bazë edhe mendimin e arkeologut Emil Çershkov, që e potencon një gjë të tillë.<sup>418</sup> Këtuillshëm prej asaj kohe e deri më tani, jemi munduar të mbledhim informacione nga treva në trajtim e që ndërlidhet me **mozaikun**, prandaj në vazhdim edhe do mundohemi ti prezentojm ato informacione.<sup>419</sup>

Në vitin 2019, gjersa përgatitnim një ekspozitë me artefakte me kolegët e profesionit dhe nxënësit e shkollës “SHMU2” në Vushtrri, njëra prej nxënësve, Albiona Barileva, krahas kontributit që dha rreth përgatitjes së ekspozitës në fjalë, ajo mëtej na sqaroi se gjetjen që e kishte sjellur në shkollë familjarët e kishin rastësishtur gjatë punëve duke gërmuar nëndhe, dhe shton se babai i saj, Naim Barileva mendon se për atë rajon flitej se ishte i **moçëm** dhe ekziston

<sup>415</sup>**Mozaiku, sipas Melsi Labit, është pikturë monumentale dekorative që përfshinë veprat e punuara me gurë kubikë të vegjël prej qelqi, qeramike, ose ndonjë materiali tjetër të qëndrueshëm me ngjyra**, për më shumë, shih punimin e tij të titulluar *Mozaikët e Shqipërisë* në gazetën “gazetadita.al/mozaikët-e-Shqipërisë/ (parë për herë të fundit më 01.08.2021).

<sup>416</sup>Jeton Sallahu, punim i pabotuar e i titulluar *Moçmëria e Vushtrrisë me rrethinë prezentuar përmes hyjnjive/kulteve dhe mjeshtria e skulptorëve vendës* dërguar për prezentim në konferencën shkencore me temë “Zejtaria dhe tregtia në Luginë të Preshevës dhe në viset shqiptare” (pritet të zhvillohet në Preshevë, tetor 2021); **Banori Naim Barileva mendon se mozaiku duhet të lypset në Vushtrri diku te shkolla “Mustafë Venhari”, “Te Bunari i Vjetër”, “Te Çeshmja” në një arë** (Vushtrri, 2019).

<sup>417</sup>Intervistë e zhvilluar me inxhinierin e teknologjisë, Suphi Metëhiun (Vushtrri, 07.07.2021).

<sup>418</sup>Fotoja u realizua nga autori i këtij punimi (Vushtrri, 07.07.2021).

<sup>419</sup>Ibid; Foto të realizuara nga autori i këtij punimi (Vushtrri, 07.07.2021).

**mozaiku.**<sup>420</sup> Mirëpo, të gjendën mozaiket në brendi të qyteteve nuk është edhe kollajshëm, nuk është punë e lehtë të bëhet, ngase popullata mund të mbanë brengën se toka, shtëpia, banesa, ndonjë objekt biznesi, apo çfardo qoftë si pasuri e tyre, mund të vij në pikëpyetje nëse monumenti në fjalë është nën to...!

Një burim tjetër që na flet për **mozaikun, varrezat**, është ai që na vjen nga inxhinieri i teknologjisë, 68 vjeçari Suphi Metëhiu, i cili mendon se monumentin të cilin po e kërkojmë mund të lypset në “trekëndshin”, respektivisht drejtimet duke pasur për nisje mullirin e tyre/ *Mullirin e Nevzatit*, të dhëna këto që ai i kishte dëgjuar nga të moshuarit ndër vite.<sup>421</sup>



Fig.3. Suphi Metëhiu, në zyren e punës në Vushtrri<sup>422</sup>



Fig.4. Dy drejtimet rrugore në të cilën flitej se ishte mozaiku dhe jo vetëm

<sup>420</sup>Intervistë...*opcit.*

<sup>421</sup>Emil Çershkov, *Ulpiana-visar i shekujve* në revisten “Përparimi” (4, 1955, Prishtinë), p.p.216-218.

<sup>422</sup>Edi Shukriu, *Mozaiku i Orfeut-zbulim i rrallë* në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike” (15-1985, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986), p.p.289-298; Për vjetërsinë e Vendenisit/Gllamnikut, shih edhe librin e studiuesit Jusuf Osmanit, *Vendbanimet e Kosovës Besiana/Podujeva* (17, Prishtinë, 2011), p.238.



Fig.5. Drejtimi tjetër i rrugës, që flitej se kishte gjëra të vjetra<sup>423</sup>

Të njejtat gjëra i kishte thënë edhe malaziasi që jetonte dikur në Vushtri, e që quhej Bata. Ai hapësirën e moçme e qonte deri *Te Zasellt, Te Shtëpia e Tafil Rrepës*.<sup>424</sup> Tutje, **mundësinë e ekzistimit të mozaikut në truallin e sotëm të Vushtrrisë**, logjikshëm na e përforcon bindjen edhe gjetjet e mëhershme të mozaiqeve në vendet e tjera, e të cilat gjeografikisht nuk janë shumë larg truallit në fjalë, e kemi vëmendjen në radhë të parë për *dy mozaiket*, atë të Ulpianës, afër Prishtinës, për të cilin na ka bërë të ditur kohë më parë arkeologu që e zëmë në gojë edhe më lartë, Emil Çershkov, me punën e tij të vyeshme, prandaj ai paraqitet edhe si **objekt i artit antik**. Sëkëndejm, njohuri më shumë mund të gjejmë edhe te punimi studimor i tij i titulluar *Ulpiana- visar i shekujve*<sup>425</sup> dhe *Mozaikun e Orfeut*, diku i shekujve II-III në Vendenis/Gllamnik të Besianës/Podujevës. Në fakt, në afërsi të vendit të fundit të përmendur, arkeologu Çershkov, e pati vendos *Station Vindenis*, duke u mbështetur nga burimet e shkruara nga antikiteti.<sup>426</sup>

<sup>423</sup>Fejaz Drançolli, *Mosaic painting in Kosova during 4-6 century* në “Kosova archaeologica Kosova arkeologjike” (1, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë, 2006), p.p.117-123.

<sup>424</sup>Edi Shukriu, *Mozaiku...opcit*.

<sup>425</sup>Bedri Xhema, *Materiale të pabotuara* (Vushtri, 27.10.2021).

<sup>426</sup>Për më shumë, shih: Skënder Anamali, *Nga ilirët tek arbërit, shqiptarët e hershëm* në librin “Studime ilire” (II, Rilindja, Prishtinë, 1978), p.p.25-33.





Fig.6.Mozaiku i Orfeut, Gllamnik

Do të thotë në mozaiket e tilla shprehet **arti, piktura muzive**, siç shprehët historiani i artit, Fejaz Drançolli në një punim të tij,<sup>427</sup> dhe njëkohësisht janë dëshmi e një zhvillimi në antikitet. Dhe pikërisht duke pasur parasysh këtë, mendojmë se edhe në trevën e Vushtrrisë së sotme, ka pasur njëfarë zhvillimi e që kjo ka mundur të reflektoj edhe me **ekzistencën e mozaikut**, prandaj edhe nuk janë për tu habitur shënimet që na sjellë S. E. Wayell i cili thotë se deri më 1979, në provnicat e Perandorisë Romake janë gjetur 47 mozaikë të Orfeut.<sup>428</sup>

Duke u zgjatur dhe pakëz për të dhënat që kemi hasur për **mozaikun**, respektivisht **mozaiket e Vushtrrisë me rrethinë**, kemi kuptuar se në vendbanimin **Gjytet/Dubovc të Vushtrrisë** ka ekzistuar mendimi nga banorët e asaj ane se atje ka pasur **mozaik**. Në fakt, banorët e asaj ane thonin, parafrzoj: *...në truallin e Kalasë së Dubovcit kishte pasur plloqa me vizatime në dysHEME.*<sup>429</sup>

Një gjë tjetër që na duket është vendi të përmendët është se **mozaiket** kanë qenë ndërtuar edhe n'kapërcim të antikitetit, respektivisht në antikitetin e vonë e mesjetën e hershme, veçanarisht në kohën e udhëheqësit të njohur bizantinas, Justinianit. Natyrisht kjo gjë vlente edhe për trevat ilire, përçka në bënë të njohur studiuesi Skënder Anamali në punimin studimor të tij të titulluar *Nga ilirët tek arbërit (shqiptarët e hershëm).*<sup>430</sup>

Për të përfunduar, mund të themi se trualli i sotëm i Vushtrrisë me rrethinë ka qenë vendbanim i “prindërve” të shqiptarëve të sotëm, ilirëve dardan në kohën e antikës, pa përjashtuar pastaj këtu edhe etnikumet e tjera që zakonisht kishin qenë pakica krahasuar me popullatën autoktone, megjithëkëtë nuk kanë munguar edhe bashkëpunimet midis tyre e pra edhe ndikimet në kulturë, siç e pamë edhe në monumentet e trajtuara.

<sup>427</sup> Krifca- Beqiri, Mirlinda, *Studime letrare*, Vatra, Shkup, 2013, f.163.

<sup>428</sup> Allen,Graham, *Intertextuality*, Routledge, Milton, Abingdon, 2011, f. 1. (përkthimi im)

<sup>429</sup> Cit. sipas Allen,Graham, *ibid*, f.13. (përkthimi im)

<sup>430</sup> Cit. sipas Krifca- Beqiri, Mirlinda, *vep. cit.*, f. 162.

## **Burimet dhe literatura**

### **I.Burimet e pabotuara**

#### **[1]. -Materiale shkrimore**

[2]. 1.Barileva, Naim, ë2019], Mozaiku në Vushtri, Vushtri.

[3]. 2.Sallahu, Jeton, ë2021], Moçmëria e Vushtrrisë me rrethinë prezentuar përmes hyjnive/kulteve dhe mjeshtria e skulptorëve vendës, në konferencën shkencore “Zejtaria dhe tregtia në Luginë të Preshevës dhe në viset shqiptare”, Preshevë.

[4]. 3.Xhema, Bedri, ë2021], Materiale të pabotuara, Vushtri.

#### **-Intervista**

[1]. 1.Suphi, Metëhiu, ë2021], Vushtri.

#### **-Fotografi**

[1]. 1.Sallahu, Jeton, ë2021], Suphi Metëhiu në zyre të punës, Vushtri.

[2]. 2.Sallahu, Jeton, ë2021], Dy drejtimet rrugore në të cilën flitej se ishte mozaiku dhe jo vetëm, Vushtri.

[3]. 3.Sallahu, Jeton, ë2021], Drejtimi tjetër i rrugës që flitej se kishte gjëra të vjetra, Vushtri.

### **II.Burimet e botuara**

#### **-Literatura**

[1]. 1.Anamali, Skënder ë1978], Nga ilirët tek arbërit, shqiptarët e hershëm në librin “Studime ilire”, Prishtinë.

[2]. 2.Osmani, Jusuf, ë2011], Vendbanimet e Kosovës Besjana/Podujeva 17, Prishtinë.

[3]. 3.Përzhita, Luan, ë2009], Mbretëria Dardane histori e shkurtër e shtetit 2400 vjeçar, Tiranë.

[4]. 4.Sallahu Jeton, Rexhepi Burim, Xhema Bedri, Zahiri Kastriot, ë2017], Çështje nga historia e Vushtrrisë me rrethinë deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, pjesa e parë, Prishtinë.

#### **-Revistat shkencore**

[1]. 1.Çershkov, Emil, ë1955], Ulpiana-visar i shekujve në revisten “Përparimi”, Prishtinë.

[2]. 2.Dobruna, Exhlale, ë1977], Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

[3]. 3.Dobruna, Exhlale, ë1982], Tipologjia e monumenteve sepulkrale të periudhës romake në Kosovë në revisten “Iliria”, Tiranë.

[4]. 4.Dobruna, Exhlale, ë1985], Plastika dekorative dhe figurative e stelave mbivarrore të periudhës romake në Kosovë në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

[5]. 5.Dobruna, Exhlale, ë1996], Veprat e artit ilir në plastikën potretore të kohës romake në trevën e Dardanisë në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

[6]. 6.Dobruna, Exhlale, ë2005], Mbi besimin në jetën e amshueshme në pjesën qendrore të Dardanisë në bazë të monumenteve sepulkrale në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

[7]. 7.Drançolli, Fejaz, ë2006], Mosaic painting in Kosova during 4-6 century në “Kosova archaeological Kosova arkeologjike”, Prishtinë.

[8]. 8.Katçiq, Radosllav, ë1972], Antroponomia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve në revisten “Jehona”, Shkup.

[9]. 9.Shukriu, Edi, ë1984], Kultura materiale dardane në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë p.e.s në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

[10]. 10.Shukriu, Edi, ë1986], Mozaiku i Orfeut-zbulim i rrallë në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.

#### **-Gazeta/portale**

[1]. 1.Labi, Melsi, Mozaikët e Shqipërisë në gazetën “gazetadita.al/mozaikët-e-Shqipërisë”.